



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2024:107927
Datë: 31.05.2024
Numri i dokumentit: 05764834

P.nr.34/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-Dega në Skenderaj, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari i vetëm gjykues Valon Hajdini, me bashkëpunëtoren profesionale Sandra Fazliu dhe procesmbajtës – praktikanti H.K., në çështjen penale ndaj të pandehurit E.Q., i akuzuar për veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.392/2024, të datës 04.04.2024. Pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit fillestar në prezencën e palëve, Prokurorit të Shtetit nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, Arjan Xhema dhe të pandehurit E.Q., seanca ka qenë publike, e njëjta është regjistruar në procesverbal, Gjykata pas përfundimit të shqyrtimit fillestar më 29.05.2024, të njëjtën ditë ka shpallur publikisht aktgjykimin, ndërsa më dt.31.05.2024 është përpiluar me shkrim ky:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

E.Q., nga i ati S., e ëma B., e vajzërisë B., i lindur me datë..., në Mitrovicë, me vendbanim në Skenderaj rruga..., me numër personal..., Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa martuar, punon në hekrarinë..., i gjendjes së dobët ekonomike.

SHPALLET FAJTOR

Më datën 23.11.2023, rreth orës 17:05, në Skenderaj, në rrugën “Fadil Rrustemi”, përkatësisht në parkingun e palestrës sportive..., i pandehuri me dashje dhe pa autorizim posedon substancë narkotike, ashtu që, zyrtarët policor, me rroba civile kishin ndaluar tani të pandehurin dhe me të afruar tek ai, i njëjti e kishte hedhur në tokë një cigare me substancë narkotike të llojit marihuane

e cila substancë është sekuestruar dhe pas ekzaminimit, në laborator të Forenzikës është konstatuar se është substancë narkotike e llojit kanabis - marihuanë që përmban Tetrahidrokanabinol (THC) me peshë neto 0.38 gram.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës

- Andaj, gjykata në bazë të neneve:1, 2, 4, 6, 7, 8, 9, 10, 17, 21, 22, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 69, dhe nenit 269 par.3 të KPRK-së, nenin 364, 365 dhe nenit 449 par. 1 dhe 2 pika 2.6, lidhur me nenin 452 par.1 të KPP-së, të pandehurit E.Q. i:

SH Q I P T O N

I.DËNIM ME GJOBË në shumë prej 1000€ (njëmijë euro), të cilën dënim-gjobë obligohet ta paguaj 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan këtë gjobë, atëherë e njëjta do të zëvendësohet me dënim me burgim, siç përcaktohet me nenin 43 par.3 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i'u përlllogaritur një ditë burgim ekuivalent me 20€ (njëzet euro) dënim me gjobë

II.DËNIM ME BURGIM TË KUSHTËZUAR në kohëzgjatje prej (1) një viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, me kusht që i pandehuri brenda periudhës kohore prej (2) një viteve, /periudha e verifikimit/, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale të natyrës të njëjtë, apo më të rëndë.

III. I pandehuri E.Q. obligohet të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 euro, si dhe shumën prej 20 euro në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në tërësi shumë prej 40 (katër dhjetë) euro, të gjitha obligohet t'i paguaj në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Gjukata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga nenit 269 par.3 të KPRK-së lidhur me nenin 276 par.1 dhe 2 nënpar 2.2 dhe 2.4 të KPRK nxjerrë këtë: URDHËR:

URDHËROHET konfiskimi i përhershëm i substancës narkotike-të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme: 0.38 gram, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të asgjësohet nga Policia e Kosovës në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë.

V. Kërkesë pasurore juridike nuk kishte.

A r s y e t i m

-Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur aktakuzën PP-II.nr. 804/24 të dt.04.04.2024, pranë Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega Skenderaj- Departamenti i përgjithshëm- Divizioni Penal ndaj të pandehurit E.Q., për shkak të veprës penale: Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KRPK-së.

-Rrjedha e procedurës penale

Më 29.05.2024 për këtë lëndë penale në kuadër të kompetencës lëndore dhe territoriale gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar. Seanca është mbajtur në prezencën e palëve: Prokurorit të shtetit në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Arjan Xhema dhe të pandehurit E.Q..

I pandehuri E.Q. në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më 29.05.2024 pas njoftimit nga Gjykata lidhur me të drejtat e tij për në këtë fazë të procedurës penale, dhe pasi që u konfirmua se i njëjti i kupton këto të drejta, i pandehuri është deklaruar se e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 269 par.1 të KRPK-së., duke shtuar se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe për pasojat dhe benifitet e pranimin të fajësisë, i vjen keq për rastin që ka ndodhur, i premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, i kërkoi falje gruas se tij për shqetësimet që ia ka shkaktuar, me të njëjtën dëshiron të bashkohet dhe të jetojnë se bashku andaj, kërkoj nga gjykata që t'i shqiptojë një dënim sa me të butë, pasi që është baba i dy fëmijëve, mbajtës i familjes.

Gjykata ka marrë mendimin e palëve në lidhje me deklarinin mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit dhe atë nga prokurori i rastit Arjan Xhema, i cili ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit meqenëse pranimi i fajësisë është bërë komfor dispozitave të nenit 242 të KPP-së, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe provat e lëndës andaj, gjykatës i propozoi që të njëjtin ta shpallë fajtor për veprën e kryer penale t'i shqiptojë një sanksion penal me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit ashtu që me rastin e matjes se llojit dhe

lartësisë së dënimit si rrethanë lehtësuese të marrë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa sa i përket rrethanave renduese shkallën e përgjegjësisë penale, motivin e kryerjes së veprës, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimin e kryerjes së veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale.

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e ka deklaruar i pandehuri E.Q. e në mbështetje të nenit 242 par.6 të KPP-së, vlerësuam se janë përmbushur kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i pandehuri. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga i pandehuri mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo aktakuzë siç janë Raporti policor me numër të rastit 2023-BF-471 i datës 23.11.2023 i punuar nga hetuesi B.B., Lista e dëshmive e datës 25.11.2023, e kaluara kriminale, e siguruar nga data baza e Policisë së Kosovës, Raporti i Ekspertimit nga AFK, i datës 14.02.2024, Foto dokumentacion, Procesverbal mbi intervistimin e të pandehurit E.Q. e datës 23.11.2023 në SP Vushtrri, andaj të gjitha këto prova janë bindëse për gjykatën dhe formojnë në tërësi elementet inkriminuese e që në bazë të tyre dhe pranimin të fajësisë nga ana e të pandehurit, përtej çdo dyshimi vërtetohet se i njëjti ka kryer veprën penale; Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 269 paragrafi 1 të KRPK-së.

Gjykata, gjen se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit E.Q. është bërë në mënyrë vullnetare dhe se ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

Gjykata i kishte tërhequr vërejtjen të pandehurit se pas pranimin të fajësisë nuk mundet të shfrytëzoj të drejtën në ankesë, për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humbë mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave të tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të marrë si rrethanë lehtësuese.

Gjykata ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë prej të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se i pandehuri E.Q. është i përgjegjshëm dhe përgjegjës (fajtor) për veprat penale për të cilat akuzohet.

-Konfiskimi

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore nga neni 269 par.3 të KPRK-së, dhe nenit 276 par.1 të KPP-së ka urdhëruar konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike-të llojit Kanabis (Marihuanë), e cila përmbanë Tetrahidrokanabinol (THC), me peshë neto të përgjithshme 0.38 gram.si dhe ka autorizuar Policinë e Kosovës që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Mitrovicë të bëjë asgjësimin e kësaj substance.

-Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, për të pandehurin E.Q., ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-ës, gjykata ka marrë për bazë faktin se i njëjti ka treguar sjellje të mira dhe paraqitje serioze në gjykatë në raport me gjykatën, pendimi i sinqertë, i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, është i punësuar nga paga e të cilit varen familjarët e tij, ndërsa si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë pranimin e fajësisë në tërësi për veprën penale për të cilën akuzohet, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë për bazë shkallën e lartë të dashjes dhe të përgjegjësisë penale së të pandehurit, faktin se kjo natyrë e veprave penale janë më të shpeshtuara në Kosovë të shprehura e në tendencë të rritjes si dhe rrezikshmërinë shoqërore që paraqet kjo vepër penale, po ashtu i njëjti është i dënuar edhe më herët për vepra penale të natyrës së njëjtë dhe atë me aktgjykimet, P.nr.394/19 i plotfuqishëm më 05.02.2021, me aktgjykimin P.nr.230/21 i plotfuqishlm më 22.04.2022.

Sa i përket dënimit me gjobë në këtë rast për të pandehurin gjykata përveç rrethanave të cekura, ka vlerësuar dhe ka marrë parasysh edhe kushtet dhe mundësitë materiale për pagimin e gjobës, duke vlerësuar se dënimi me gjobë i shqiptuar për të pandehurin është i përballueshëm për kushtet ekonomike të tij.

Gjykata, vlerëson se dënim me gjobë në shumën prej dyqind e pesëdhjetë (250) euro dhe dënimi i kushtëzuar me burgim, i shqiptuar ndaj të pandehurit, në raport me shkallën e përgjegjësisë, rrezikshmërinë e veprës penale, moshën e të pandehurit dhe rrethanat tjera që kemi cekur është adekuat dhe ne si gjykatë jemi plotësisht të bindur se do të arrihet qëllimi i dënimit në raport me të pandehurin por edhe në raport me personat tjerë, që të përmbahen nga sjelljet që cenojnë rendin dhe ligjin.

-Shpenzimet e procedurës penale

Duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPPK-së, gjykata ka përcaktuar shpenzimet procedurale në shumën prej (20) njëzet euro dhe (20) njëzet në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, në total prej (40) katërdhjetë euro.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 364 dhe 369 të KPPK-së është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA SKENDERAJ

Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal

P.nr.34/2024 të datës 31.05.2024.

Procesmbajtës

H.K.

Gjyqtari i vetëm gjykues

Valon Hajdini

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën.